



## **PYETËSOR PËR KONGRESIN E XX-të TË KONFERENCËS SË GJYKATAVE KUSHTETUESE EVROPIANE (CECC), 2027**

Në përputhje me Rezolutën III të miratuar nga Rrethi i Kryetarëve në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2025 në Tiranë, tema e Kongresit të XX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane, i cila do të zhvillohet në Shqipëri në vitin 2027, do të jetë:

### **LIRIA E SHPREHJES – LAJMET E RREME (FAKE NEWS) SI KËRCËNIM PËR DEMOKRACINË**

**Seksioni 1: E drejta e lirisë së shprehjes dhe e informimit. Ndërhyrja në dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut – parashikimet kushtetuese dhe kufizimet e jurisprudencës**

1. Si e përkufizoni të drejtën e lirisë së shprehjes në tekstet ligjore dhe në jurisprudencën tuaj? Për këtë qëllim, a i jeni referuar jurisprudencës së vendeve të tjera apo parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut?
2. Cilat janë kriteret që lejojnë kufizimin e lirisë së shprehjes? Si i vlerësoni këto kriteret, veçanërisht në rastet që përfshijnë dezinformimin ose lajmet e rreme?
3. Si është zbatuar ose interpretuar liria e shprehjes në kontekstin e proceseve zgjedhore, dhe si harmonizohet ajo me të drejtën për informim?
4. A ka evoluar përkufizimi apo fusha e veprimit të së drejtës së lirisë së shprehjes në dritën e zhvillimeve teknologjike – duke pasur parasysh këtu platformat e mediave sociale, përhapjen në kohë reale dhe në masë të informacionit, si dhe diskutimin publik përmes mjeteve digjitale?
5. A ekziston një kuadër ligjor që përcakton kriteret për identifikimin dhe klasifikimin e lajmeve të rreme, dezinformimit, keqinformimit apo përmbajtjeve të manipuluar, si *deepfakes*? A merr në konsideratë Gjykata faktorë të tillë si qëllimi për të mashtruar,



shkalla e dëmit të shkaktuar, apo besueshmëria e burimit? A keni bërë ju një ndarje të qartë mes deklaratave të fakteve të rreme (*fake news*) dhe shprehjeve të opinionit të bazuara mbi vlera ose të natyrës subjektive?

6. Si ndikon liria e shprehjes në të drejtat dhe vlerat e tjera themelore, si dinjiteti njerëzor, e drejta për reputacion, privatësia, e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur, dhe rendi publik? Si sigurohet një ekuilibër i tillë në rastet e shpifjes që lidhen me lajmet e rreme ose keqinformimin?
7. A ka dhënë Gjykata juaj vendime të rëndësishme që interpretojnë ose kufizojnë lirinë e shprehjes ose të drejtën për informim, veçanërisht në rastet që përfshijnë keqinformimin, dezinformimin, ose lajmet e rreme? A e keni modifikuar jurisprudencën tuaj?

## **Seksioni 2: Demokracia, Integriteti Zgjedhor dhe Lajmet e Rreme**

1. A e ka trajtuar Gjykata juaj marrëdhënien midis lirisë së shprehjes, së drejtës për të marrë informacion dhe ushtrimin efektiv të të drejtave demokratike, në veçanti të së drejtës për të votuar dhe të së drejtës për të kandiduar në zgjedhje?
2. Si ndikon përhapja e lajmeve të rreme gjatë fushatave elektorale në zgjedhjen e elektoratit, e cila duhet të bazohet te aksesimi në informacion të vërtetë, të besueshëm dhe të verifikueshëm? Si ndikon ajo në reputacionin e kandidatëve dhe në rezultatin e zgjedhjeve?
3. Çfarë standardesh kushtetuese ose ligjore aplikon Gjykata juaj kur vlerëson kufizimet për përhapjen e lajmeve të rreme gjatë periudhave zgjedhore? A e përdorni kriterin e proporcionalitetit?
4. A ka gjykuar Gjykata juaj çështje për të cilat është konstatuar se përhapja e lajmeve të rreme, keqinformimit ose përmbajtjes së manipuluar (p.sh. *deepfakes*) ka ndërhyrë në proceset demokratike si zgjedhjet, referendimet apo funksionimi parlamentar? Ju lutemi jepni shembuj dhe shpjegoni se si Gjykata ka gjetur një ekuilibër midis interesave konkurruese të lirisë së shprehjes dhe integritetit demokratik në vendimet e saj.
5. Si vlerësohet kushtetutshmëria e masave ndërhyrëse – si ndalimi i mediave, heqja e përmbajtjeve online apo masa të tjera – që synojnë kundërshtimin e fushatave ndërkufitare



të dezinformimit – në dritën e parimeve kushtetuese të lirisë së shprehjes, sigurisë kombëtare dhe integritetit zgjedhor?

### **Seksioni 3: Platformat Digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe Kërcënimi i Dezinformimit ndaj Diskursit Demokratik**

1. A ka vendime mbi përdorimin, rregullimin ose mbikëqyrjen e teknologjive të reja – sikurse inteligjenca artificiale – në përhapjen ose moderimin e informacionit, përfshirë këtu edhe lajmet e rreme?
2. A kanë qenë objekt i kontrollit kushtetues normat që rregullojnë përgjegjësinë e platformave digjitale dhe ndërmjetësve të mediave sociale në përhapjen e lajmeve të rreme ose keqinformimit?
3. A ekziston jurisprudencë kushtetuese që trajton mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe mediave tradicionale në çështjet që lidhen me pretendime për lajme të rreme ose keqinformim?
4. A ka vendosur Gjykata juaj lidhur me masa të veçanta mbrojtjeje për gazetarinë investigative, sinjalizuesit (*whistleblowers*) ose raportimin me interes publik?
5. Si i ka adresuar Gjykata juaj sfidat që lidhen me rolin e mediave sociale dhe platformave digjitale në lehtësimin e përhapjes së keqinformimit? A e bën jurisprudenca juaj dallimin midis përgjegjësive të aktorëve të ndryshëm – si përdoruesit individualë, subjektet mediatike apo platformat online – sa i përket mbrojtjeve apo kufizimeve kushtetuese?
6. A ka shqyrtuar Gjykata juaj çështje që përfshijnë përdorimin e teknologjive të reja si përmbajtja e gjeneruar nga inteligjenca artificiale, *deepfakes* ose mjete të automatizuara për keqinformim? Cilat janë çështjet kushtetuese që janë ngritur dhe si janë trajtuar ato nga Gjykata?



#### **Seksioni 4: Perspektivat Krahasuese dhe Institucionale**

1. Në çfarë mase mbështetet Gjykata juaj në të drejtën kushtetuese të krahasuar ose në jurisprudencën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut (p.sh., GJEDNJ, dokumentet e Komisionit të Venecias ose instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut) gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me lirinë e shprehjes dhe lajmet e rreme, apo keqinformimin? Ju lutemi, jepni shembuj nëse ka të tillë.
2. A përfshihet Gjykata juaj në dialogun gjyqësor ose bashkëpunimin me gjykatat e tjera kushtetuese/institucionet homologe për adresimin e këtyre sfidave? Ju lutemi, përshkruani mekanizmat ekzistuese.
3. Në çfarë mase është ndikuar jurisprudenca e Gjykatës suaj për lirinë e shprehjes, veçanërisht në lidhje me keqinformimin ose lajmet e rreme, nga dialogu gjyqësor dhe bashkëpunimi me gjykatat e tjera kushtetuese, organet supranacionale të të drejtave të njeriut ose institucionet ndërkombëtare?
4. Cilat janë sfidat institucionale ose të tjera me të cilat përballet Gjykata juaj në trajtimin e këtyre çështjeve, si p.sh. kufizimet e burimeve, mungesa e ekspertizës teknike apo presionet politike? Si përpiqet Gjykata t'i kapërcejë këto vështirësi?
5. A ekzistojnë mekanizma mbrojtës kur dezinformimi synon institucionin tuaj ose anëtarët e tij gjatë proceseve gjyqësore? Nëse po, jepni disa shembuj. A ekziston mbrojtje ligjore ose institucionale në këtë drejtim?
6. A ka kontribuar praktika dhe jurisprudenca e Gjykatës suaj në reforma ligjore ose politika që synojnë luftën kundër lajmeve të rreme ose rregullimin e mediave digjitale? Nëse po, ju lutemi jepni shembuj.
7. Çfarë masash institucionale ka ndërmarrë Gjykata juaj për forcimin e kapaciteteve të saj për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me lajmet e rreme dhe lirinë e shprehjes në kontekstin digjital, si p.sh. trajnime, konsultime me ekspertë ose bashkëpunim ndërinstitucional?



## Materiali koncept dhe metodologjia e pyetësorit

Ky pyetësor është hartuar me qëllim nxitjen e një dialogu të thelluar, mbi bazën e jurisprudencave të pasura dhe me një vizion të qartë për të ardhmen, ndërmjet gjykatave kushtetuese të Evropës. I mbështetur në temën kryesore të Kongresit “Liria e Shprehjes – Lajmet e Rreme si Kërcënim për Demokracinë”, pyetësori pasqyron një përpjekje të mirëmenduar jo vetëm për të mbledhur informacion, por edhe për të nxitur reflektimin kritik mbi një nga sfidat kushtetuese më urgjente dhe komplekse të kohës sonë.

Jemi dëshmitarë të një periudhe ku mënyra se si prodhohet, shpërndahet dhe konsumohet informacioni po pëson një transformim rrënjësor. Rritja eksponenciale e platformave digjitale, shfaqja e inteligjencës artificiale në gjenerimin e përmbajtjeve dhe shtrirja globale e dezinformimit kanë ndryshuar rrënjësisht hapësirën publike. Këto zhvillime sfidojnë vetë themelet e shoqërive demokratike dhe adresojnë pyetje të ndërlikuara para gjykatave kushtetuese — veçanërisht kur përmbajtja mashtruese shfrytëzohet për të minuar besimin publik, për të polarizuar opinionin dhe për të ndërhyrë në proceset demokratike. Në këtë kontekst, roli i gjykimit kushtetues si mbrojtës i të drejtave themelore dhe, në të njëjtën kohë, si garantues i legjitimitetit demokratik bëhet më i rëndësishëm se kurrë.

Për sa më sipër, pyetësori është konceptuar me kujdes për t’i mundësuar çdo gjykatë që të artikulojë identitetin e saj kushtetues, metodologjinë interpretuese dhe përvojën institucionale, duke kontribuar njëkohësisht në një kuptim të përbashkët dhe krahasues të kontekstit kushtetues në evolucionin në Evropë.

Qasja metodologjike që qëndron në themel të pyetësorit është ndërtuar mbi parimet e mëposhtme:

- **Thellësi reflektimi:** Pyetjet janë formuluar për të nxitur përgjigje të plota, të mbështetura në tekstet kushtetuese, jurisprudencën dhe praktikën institucionale.
- **Dimensioni krahasues:** Struktura nxit një analizë të plotë dhe përtej kombëtare, duke respektuar në të njëjtën kohë edhe larminë e traditave kushtetuese.
- **Përshtatja ndaj ndryshimeve:** Një rëndësi e veçantë i është kushtuar tendencave të reja jurisprudenciale që formësohen nga transformimi teknologjik dhe dezinformimi digjital.
- **Rëndësia praktike:** Pyetësori synon të përfshijë jo vetëm zhvillimet doktrinare, por edhe sfidat konkrete me të cilat përballen gjykatat gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me lirinë e shprehjes dhe keqinformimin.



Ky model metodologjik ndërtohet edhe mbi trashëgiminë intelektuale të Kongreseve të mëparshme. Në veçanti, Kongresi i XVIII-të, i cili iu dedikua temës “*Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Marrëdhënia midis Katalogëve Kombëtare, Supranacionalë dhe Ndërkombëtarë në shekullin XXI*”, e trajtoi lirinë e shprehjes si një element thelbësor të katalogut të të drejtave. Me këtë rast, të gjitha gjykatat anëtare dhanë përkufizime kushtetuese dhe ligjore të kësaj të drejte, duke krijuar kështu një bazë krahasimore të përbashkët. Kjo vazhdimësi shpjegon edhe arsyen përse ky pyetësor nuk ndalet në mënyrë të thelluar tek pyetjet që synojnë të nxjerrin përkufizime kushtetuese dhe ligjore të lirisë së shprehjes brenda kuadrit të brendshëm ligjor të gjykatave anëtare — çështje që u trajtuan në mënyrë gjithëpërfshirëse gjatë Kongresit të XVIII-të. Për këtë arsye, fokusi i tanishëm qëndron mbi sfidat e reja dhe komplekse që lindin nga teknologjitë digjitale, fenomeni i dezinformimit dhe ndikimi i tyre mbi integritetin demokratik.

## Struktura e Pyetësorit

Pyetësori ndjek një ecuri tematike, duke e orientuar çdo Gjykatë drejt zhvillimit logjik të çështjeve të adresuara — nga parimet themelore deri tek sfidat e epokës digjitale. Katër seksionet janë si më poshtë:

1. **Seksioni 1: Liria e shprehjes dhe e informimit. Ndërhyrja në dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut – parashikimet kushtetuese dhe kufizimet e jurisprudencës**  
Shqyrton bazën kushtetuese të lirisë së shprehjes, duke përfshirë kufizimet e lejueshme dhe qëndrimet jurisprudenciale ndaj dezinformimit.
2. **Seksioni II – Demokracia, Integriteti Zgjedhor dhe Lajmet e Rreme**  
Analizon ndërveprimin midis lirisë së shprehjes, të drejtave zgjedhore dhe kërcënimeve që dezinformimi paraqet për legjitimitetin demokratik dhe drejtësinë zgjedhore.
3. **Seksioni III – Platformat Digjitale, Inteligjenca Artificiale dhe Kërcënimi i Dezinformimit ndaj Diskursit Demokratik.** Trajton implikimet kushtetuese të teknologjive të reja, rolin dhe përgjegjësitë e platformave digjitale dhe ndërmjetësve, si dhe mbrojtjen e lirisë gazetareske.
4. **Seksioni IV – Perspektiva Krahasuese dhe Institucionale**  
Shqyrton rolin e së drejtës kushtetuese të krahasuar, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kapacitetin institucional për trajtimin e sfidave që paraqiten nga dezinformimi.

Kjo strukturë siguron qartësi konceptuale, ecuri logjike dhe koherencë, duke mundësuar që secila gjykatë të artikulojë përvojën e saj kushtetuese, ndërkohë që kontribuon në një kuptim të përbashkët evropian për lirinë e shprehjes në epokën digjitale.